



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 220/2 Prot.

Tiranë, më 09.03.2018

**VENDIM**

Nr.11, datë 09/03/2018

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË  
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NJËSINË E VETËQEVERISJES  
VENDORE BASHKIA GJIROKASTËR DHE PARALAJMËRIMIN E  
INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Gjirokastrë,

**KONSTATOVA SE:**

Me Vendimin nr. 216, datë 25.10.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gjirokastrë dhe Bashkia Dropull”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Gjirokastrë.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 1731/1 prot., datë 25.10.2017, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me

shkresën nr. 1731/2 prot., datë 25.10.2017, “Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Bashkinë Gjirokastër”, i është njoftuar Bashkisë Gjirokastër.

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 220 prot., datë 1.2.2018, “*Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gjirokastër, në lidhje me administrimin e shërbimit civil.*”, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i punës.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr. 809/1 prot., datë 19.2.2018, “*Kthim përgjigje*”, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Gjirokastër, dhe të

paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Kryetari i Bashkisë, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullohen pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit:

✓ \*\*\*\*\*, Specialiste, Zyra e Integritetit në BE, akti nr. 177, datë 5.4.2016.

✓ \*\*\*\*\*, Specialiste, Zyra e Integritetit në BE, akti nr. 178, datë 5.4.2016

Njësia përgjegjëse, të kryejë procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, sipas orientimeve në raportin e mbikëqyrjes.

3. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, me qëllim që të rregullojë situatën në lidhje me deklarin e statusit të punësimit për nëpunësin \*\*\*\*\*, aktualisht i punësuar në pozicionin e punës, “Drejtor në Drejtorinë e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit të Territorit”, të veprojë si më poshtë:

✓ Të ndryshojë aktin administrativ nr. 1576, datë 29.5.2014, për deklarin e statusit të punësimit, duke e ndryshuar pozicionin e tij në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit të këtij punonjësi, në pozicionin e punës, është më pak se 1 vit.

✓ Të administrojë në dosjen e personelit, vlerësimin e punës për periudhën e provës si dhe mendimin me shkrim nga nëpunësi më i vjetër.

✓ Eprori direkt, të nxjerrë për nëpunësin vendimin e arsyetuar të konfirmimit dhe më pas njësia përgjegjëse, të bëjë deklarin e statusit të punësimit “nëpunës civil në pozicionin drejtor”.

4. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, të drejtojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, në bashkëpunim me subjektet e tjera të ngarkuara me ligj (*analisti i punës, eprori direkt dhe drejtori i përgjithshëm*), sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e

*pavarura*”, i ndryshuar dhe lidhjeve të cilat janë pjesë e këtij vendimi si dhe udhëzimit nr. 1 datë 31.5.2017, të Departamentit të Administratës Publike. Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë përcaktuar procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen për hartimin e përshkrimeve të punës, nëpunësit përgjegjës për hartimin e tyre, strukturën përgjegjëse për vlerësimin e bazueshmërisë së tyre në ligjin specifik dhe formatin e miratuar, organin që ka kompetencën për miratimin e tyre, si dhe detyrimin për depozitimin pranë njësisë përgjegjëse.

Për plotësimin e këtij detyrimi, njësia përgjegjëse, të zbatojë orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Më pas, një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkuara, të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe të mbahen parasysh gjatë procesit të miratimit të strukturës përfundimtare të institucionit, si një detyrim ligjor që rrjedh prej ligjit që rregullon funksionimin e njësive vendore, i cili ka përcaktuar vitin 2018, si afatin e strukturimit përfundimtar të këtyre njësive, pas implementimit të reformës territoriale dhe ndërkohë, një kopje e përshkrimeve të punës, të depozitohet në arkivin e institucionit.

Njësia përgjegjëse, të njoftojë të gjithë subjektet që ligji i ngarkon me administrimin e aspekteve të veçanta të shërbimit civil.

5. Njësia përgjegjëse e institucionit, me qëllim realizimin e një strukture administrative, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, duhet të fillojë menjëherë punën për saktësimin e pozicioneve të cilat kanë karakteristikat e shërbimit civil, të përfshira në njësitë e strukturës aktuale, në rastin e agjencive dhe njësive administrative, duke ndjekur këto orientime:

- ✓ Për pozicionet e punës të përfshira në strukturën e Bashkisë si, “*Specialist i apelimit dhe marrëdhënieve me komunitetin*”, si dhe “*Sekretar, protokoll-arkivë pranë Njesisë Administrative*”, njësia përgjegjëse, të vlerësojë për secilin pozicion, nëse ai realizon funksione apo detyra në përputhje me përcaktimet e shkronjës “c”, të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe në rast se vlerësohen në kategorinë e nëpunësit civil, atëherë të rregullohet emërtesa e pozicionit të punës në përputhje me nenin 19, të ligjit, të hartohen formularët e përshkrimit të punës në bashkëpunim me eprorin dhe të zbatohen kërkesat ligjore për plotësimin e këtyre pozicioneve.
- ✓ Për pozicionet e punës të përfshira në strukturat e agjencive, njësia përgjegjëse, duhet të përcaktojë qartë detyrat teknike dhe përgjegjësitë ligjore që realizon secili pozicion pune, të vlerësojë për secilin pozicion, nëse ai

realizon funksione apo detyra në përputhje me përcaktimet e shkronjës “c” apo shkronjës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Për pozicionet e punës që do të konsiderohen pjesë e shërbimit civil, të përcaktojë emërtesat e tyre sipas ligjit për nëpunësin civil dhe plotësimi i pozicioneve të punës të bëhet në përputhje me procedurat e konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Gjithashtu, duhet të rishikojë pozicionimin e punonjësve, të cilët, në momentin e ristrukturimit, kanë kaluar nga bashkia në agjenci dhe për pasojë i ka ndryshuar regjimi juridik i marrëdhënies së punës, nga nëpunës civil në punonjës, duke i përfshirë ata përsëri në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil (*nëpunësit civil të Drejtorisë së të Ardhurave Tatim – Taksa*).

Në këtë rast, së pari, duhet të mbahet parasysh nga njësia përgjegjëse fakti, që këta nëpunës, e gëzojnë statusin e nëpunësit civil që në momentin e deklarimit të tyre në pozicionet e punës në bashki dhe për pasojë bazuar në pikën 8, të nenit 50, të ligjit për nëpunësin civil, kanë të drejtë që, brenda periudhës 2 vjeçare, pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil:

- a) të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji.
- b) të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil.

6. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelat aneks, të cilat janë pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
8. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Gjirokastrë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e

Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet administrative që provojnë masat e marra.

9. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
10. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjatitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**